



Datë: 13.06.2025

Numër Protokolli: 4027/2025

A.nr.792/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.792/2025, të datës 02.05.2025, të parashtruar nga ankuesja M.H-B, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.792/2025, e datës 02.05.2025, e parashtruar nga ankuesja M.H-B.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, M.H-B, (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 02.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, për shkak të mos klasifikimit të pozitës së saj “*Zyrtare e Lartë Zotuese*” në kategorinë e Grupit të Specialistëve sipas dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa kjo e fundit më datë 18.05.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2919/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 02.05.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Vendimin e DMZP i datës 18.03.2025; E-mailin e datës 03.04.2025; Diplomë e datës 08.12.2010; Çertifikatë e datës 21.04.2001; Diplomë e datës 15.02.2013; Çertifikatë e datës 06.02.2013; Akt emërimit e a ankueses të datës 17.01.2012; Kërkesën

për përgjigje në ankesë e datës 13.05.2025; Përgjigjen e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të datës 18.05.2025.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 17.01.2012, ka mbajtur pozitën e punës *Zyrtar e Lartë Financiare*, në Ministrinë e Infrastrukturës (tani Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, tutje MMPHI). Organi i punësimit, respektivisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas miratimit të Rregullores (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datë 29.03.2024 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, i është nënshtruar procesit të ristrukturimit të brendshëm, ashtu që Komisioni përkatës i Ristrukturimit për MMPHI me datë 03.03.2025 nga nxjerrë Raportin e Punës me shifër Nr.191 përmes të cilët ka dhënë rekomandim që ankuesja të sistemohet në pozitën e punës “Zyrtare e lartë zotuese”, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me datë 18.03.2025 ka nxjerrë vendimin me shifër:367, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 14 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ankuesen e ka transferuar në pozitën e punës “Zyrtare e lartë zotuese” në Divizionin e Financave-Departamenti i Buxhetit dhe Financa në kuadër MMPHI-së.

Ankuesja në ankesën e parashtruar me datë 02.05.2025 në Këshill, ne parim nuk e konteston Vendimin e datës 18.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, mirëpo e konteston faktin se pozita në të cilën është transferuar Zyrtare e Lartë Zotuese (Kategoria Profesional 1, Klasa I12, Koeficienti 5.75) duhet të ri klasifikohet në Grupin Specialist sipas përcaktimeve në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, me arsyetimin se klasifikimi i pozitës Zyrtare e Lartë Zotuese nuk përkon me kualifikimet profesionale, kompleksitetin e natyrës së punës de përvojës së saj, më kërkesën që Këshilli të aprovoi kërkesën e saj dhe të harmonizoi pozitën e saj në kuptim të kompensimit me nivelin Specialist, Klasa I11, koeficient 7.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, fillimisht konstaton faktin se pozita e punës Zyrtare e lartë zotuese, në MMPHI-së, hynë në kuadër të kategorisë Profesional 1, me klasë dhe koeficient të pagës I12, 5.75, ndërsa sipas nenit 38 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: “2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtoren/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtoren/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtoren/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike; dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional”, kurse një kategorizim i njëjtë është paraparë edhe sipas nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, mirëpo kjo rregullore me nenin 8 ka përcaktuar se: “Kategoria e specialistëve është kategoria përgjegjëse për kryerjen e detyrave të veçanta profesionale që kërkojnë përgatitje specifike sipas fushave të përcaktuara në Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje”, e si rezultat i kësaj sipas Shtojcës Nr.1/4 të kësaj rregulloreje tek përshkrimi për klasën e specialistëve është paraparë: “Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale. Mbajtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash

*të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi. Mbajtësit e këtyre pozitave punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave”, ndërsa në kuadër të kësaj shtojce tek arsimit i kërkuar për pozitën e specialistëve është paraparë *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në fushat e inxhinierisë, planifikim hapësinor, arkitekturë, urbanizëm, gjeodezi, kimi, fizikë, matematikë, biologji, mjekësi, farmaci, biokimi, ekologji, pylltari, bujqësi, veterinari, gjeografi, ambient, astronomi, astrofizikë, pa përfshirë drejtimet arsimore.**

Kolegji i Këshillit, për të shqyrtuar tutje pretendimin ankimor dhe duke marr parasysh faktin se ankuesja është sistemuar në pozitën Zyrtar e Lartë Zotuese sipas Vendimit të datës 18.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ju referua edhe katalogut të vendeve të punës në shërbimin civil i miratuar sipas Vendimit me Nr.08/226 të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku pozita në të cilën është caktuar ankuesja hyn në kuadër të Grupi i buxhetit dhe financave rrjedhimisht nëse i referohemi këtij grupi që është përcaktuar në kuadër të Shtojcës Nr. 2 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, për Grupi i buxhetit dhe financave apo mbledhjes së të ardhurave fusha e arsimit/drejtimet kërkohet: *Ekonomik, financa apo kontabilitet*, njëjtë është paraparë edhe me katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankueses nuk është i bazuar, ngase nuk gjen mbështetje në dispozitat e ligjit material, respektivisht për pozitën respektive apo grupin përkatës që i përket pozita në fjalë, nuk kërkohen kriteret përkatëse të kualifikimit arsimor sipas përcaktimeve nga neni 4 i Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërlidhur me nenin 8 dhe Shtojcës Nr.1/4 të së njëjtës rregullore dhe si rrjedhojë pozita Zyrtar i lartë për zotime nuk mund të klasifikohet në kuadër të kategorisë së specialistëve sikurse ankuesja pretendon.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.792/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses M.H.B;
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB
- Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.